



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI I BASHKISË MEMALIAJ

Nr. 2399 prot.

3

Memaliaj më 24.12. 2025

Procesverbal

I mbajtur sot më datë 24.12.2025 në sallën e mbledhjeve të Këshillit.

Kryesuesi i mbledhjes Z. Erjon Sinanaj/Kryetar këshilli.

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e fillimit të mbledhjes 13 këshilltarë.

Mbledhja deklarohet e hapur.

Njihen këshilltarët me rendin e ditës.

Esmerald Xhemali: Propozoj pika 2 dhe 3 të hiqet nga rendi i ditës, duke qenë se nuk janë respektuar afatet ligjore dhe jemi në periudhën që po studiojmë dhe mendoj të marrim kohën e duhur.

Xhevit Kacorri: Përsa i përket mbledhjes jashtë radhe kush e ka kërkuar sepse e kemi bërë një mbledhje.

Erjon Sinanaj: Kjo mbledhje është vendosur nga kryesia pas një diskutimi të gjatë Z. Xhevit dhe vendosi me argumentin për t'u mbledhur sepse ky buxhet është për komunitetin me shpresën se nuk do të përsëritet nga administrata e njëjta situatë.

Arsola Muzha: Ne u mbledhëm në komisione, juristja e bashkisë Znj. Xhuvana Kuçi na tha jeni në shkelje për këtë mbledhje për miratimin e buxhetit.

Petrit Lumani: Kryesia është mbledhur në përpjekje të saj në kundërshti të problematikave që na ka sjellë bashkia. E shkeli ligjin bashkia për zbatimin e afateve dhe ne në shërbim të këtij komuniteti dhe ne e "shkelëm" ligjin.

Flamur Mushamati: Unë propozoj të mos hiqen pasi ne jemi mbledhur 3 orë këtu dhe e dimë që janë shkelur afatet nga juristja.

Taulant Rama: Ky afat është brenda 10 ditëve apo deri në 10 ditë.

Xhuvana Kuçi: Ligji thotë 10 ditë pune janë që duhet të shqyrtohet në lidhje me buxhetin kjo nuk është respektuar nga kryesia.

Irena Jaupi: A ju thoni se jemi mbledhur para afatit?

Xhuvana Kuçi: Unë kam thënë që këto materiale kanë ardhur para kohe. Çfarë buxheti do të votoni?

Petrit Lumani: A e kërkon ligji që të jetë i pranishëm kryetari i bashkisë?

[Handwritten signatures and initials in blue ink]

Xhuvana Kuçi: Kryetari e ka detyrë të vij dhe e ka marrë njoftimin nga ana juaj. Vjen apo s'vjen këtë se di .

Hidhet në votim propozimi i Esmerald Xhemali heqja e pikës 2 dhe 3.

Vota Pro 2 vota. E. Xh, A.M

Vota Kundër 6 vota

Vota Abstenim 4 vota.

Hidhet në votim rendi i ditës .

Vota Pro 9 vota.

Vota Kundër 2 vota. E .Xh, A.M

Vota Abstenim 2 vota. T.R, B.M

Pika 2 e rendit të ditës: Miratimi i taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026".

Anest Halili: Para se të fillojmë diskutimin dua të vij këtu kryetari i bashkisë. Ky është turp miratohet buxheti dhe nuk vjen kryetari i bashkisë.

Taulant Rama: Kjo shprehet qartë në 139/ 2015 . Kryetari i bashkisë duhet të jetë prezent.

Erjon Sinanaj: Jemi përballë kësaj situatë do ti hedhim në votim.

Anest Halili: Meqënëse kryetari i bashkisë nuk është të thërrasim mediat.

Xhevit Kacorri: Ta shqyrtojmë këtë buxhet.

Irena Jaupi: Propozoj heqjen e tarifës së parkimit.

Relaton sipas relacionit bashkangjitur Znj. Anxhela Isomati/specialiste e taksave.

Irena Jaupi: A kishte ndryshime në kullota?

Esmerald Xhemali: Propozoj të kalohet me ndryshime. Të lihet në fuqi paketa e vitit 2025 me ndryshime sipas vkm nr.467 datë 13.7.2025.

Asqeri Muçoima: Nga kontaktet që kam pasur me dis biznese të vogla të zonës më kanë shprehur shqetësimin për taksën e pastrimit.

Kryetari hedh në votim propozimin e Esmerald Xhemalit të lihet në fuqi paketa e vitit 2025 me ndryshime sipas vkm nr.467 datë 13.7.2025.

Vota Pro 12 vota.

Vota Kundër 0 vota.

Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

Taulant Rama nuk mori pjesë në votim.

Pika 3 e rendit të ditës: Miratimi i buxhetit për vitin 2026.

Besnik Caushi: Unë nuk e mbroj buxhetin çfarë buxheti do miratoni ju?

Flamur Mushamati: Ne duan të miratojmë buxhetin sepse materialet më në fund kanë ardhur këta nuk relatojnë, këtë se kuptoj.

Xhevit Kacorri: Përse nuk transmetohet mbledhja live.

Erjon Sinanaj: Z. Xhevit jemi dakord të dalim live por nuk mundemi për shkak të logjistikës, kushtet teknike nuk i kemi.

Flamur Mushamati: Ne i bie që muajin tjetër të diskutojmë prapë buxhetin, mendoj të vazhdojmë duke e kaluar në votim.

Arsola Muzha: Në buxhetin e bashkisë nuk është përfshirë buxheti i këshillt. Votojeni!

Kryetari e hedh në votim projekt vendimin : Për miratimin e buxhetit për vitin 2026.

Vota Pro 9 vota

Vota Kundër 2 vota. E. Xh, A.M

Vota Abstenim 2 vota. T.R, Xh.K Miratohet.

Mbledhja deklarohet e mbyllur.

Këshilltarë pjesëmarrës.

1. Petrit Lumani
2. Asqeri Muçoima
3. Bujar Mamaj
4. Arsola Muzha
5. Lauresha Lila
6. Taulant Rama
7. Afize Sula
8. Anest Halili
10. Xhevit Kacorri
11. Esmerald Xhemali
12. Arsola Muzha
13. Erjon Sinanaj
14. Jrena Jauja

Maltona Beuxha
Sekretari i Këshillit
Erjola Allka

Beuxha
Kryetari i Këshillit
Erjon Sinanaj